

VENDIM
Nr. 49, datë 31.3.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS SË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGJI
UNIVERS” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4 pika 1 germa “e”; 5 pika 1 germa “e” dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k, dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr.20, datë 31.1.2017, vendosi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për mangësi në dokumentacionin e aplikimit.

- Në vijim të sa më sipër shoqëria “Energji Univers” sh.p.k. ka hapur në QKB çështjen me nr. CN-161093-02-17, datë 17.2.2017, e cila ka lidhje me depozitimin e vendimit të asamblesë datë 09.02.2017, duke përfshirë në objekt të veprimtarisë së saj, tregtimin e energjisë elektrike.

- Shoqëria “Energji Univers” sh.p.k., ka paraqitur në ERE me shkresën nr. 119/4, datë 28.2.2017, formatin e aplikimit, ekstratin e QKB, si dhe një deklaratë e cila shpreh se vendos në dispozicion të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike shumën 25.000 euro në llogarinë e saj bankare në Raiffeissen Bank.

- Aplikimi i shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.8 germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti